

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT**  
**DHE SPORTIT**  
**MINISTRI**

424  
Nr. 424/Prot.  
2015

Tiranë, më 17 . 06. 2015

**URDHËR**  
Nr. 242, datë 17.06.2015

**PËR**  
**AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, JOUNIVERSITAR, PROFESIONAL,**  
**PAS ARSIMIT TË MESËM, QË PËRFUNDON ME DIPLOMË PROFESIONALE NË**  
**"EFIÇENCË ENERGJITIKE", TË UNIVERSITETIT "POLIS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin e programit të studimit, jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, të ofruar nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, të universitetit "Polis", në kuadër të projektit Tempus nr. 543782-tempus-1-2013-1-AL-Tempus-JPCR, me kohë të plotë dhe kohëzgjatje 2 vite akademike, i cili realizohet me 120 kredite (ECTS), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale në "Efiçencë Energjitike", në përputhje me vendimin nr. 31, datë 27.03.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Universiteti "Polis", do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programit të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, në zbatim të pikës 4 të nenit 62 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe universiteti "Polis".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

